



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Tiranë më 05.05.2026

Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare është Person juridik në varësi të Këshillit të Ministrave, e cila vepron në përputhje me ligjin Nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore” i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr. 34, datë 07.01.1999, “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe Trajtimin e Personaliteteve të Larta Shtetërore” i ndryshuar. Në zbatim të Vendimit Nr. 744 datë 12.12.2025 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare”, të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 226 datë 12.12.2025, “Për Miratimin e Organikës së Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare”, si dhe të Rregullores së Brendshme të DSHQ-së, njofton hapjen e konkurrimit për vend të lirë pune si vijon:

Të dhënat për pozicionin e punës:

Emërtesa e pozicionit:	Specialist Inxhinier (1 vend)
Institucioni:	Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare
Drejtoria:	Drejtorja e Menaxhimit të Godinave Shtetërore
Spektori:	Spektori i Administrimit dhe Mirëmbajtjes
Kategoria e pagës:	IV-1

Përshkrimi përgjithshëm i pozicionit të punës:

Specialisti Inxhinier është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e sistemeve inxhinierike të godinave, duke garantuar funksionimin e tyre të sigurt dhe efikas. Ai harton dhe zbaton plane mirëmbajtjeje preventive, si dhe koordinon ndërhyrjet për riparime emergjente, duke siguruar reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj problematikave të shfaqura. Në kuadër të detyrave, bashkëpunon me ekipin teknik për zgjidhjen e problematikave dhe realizimin e projekteve të riparimit, kryen inspektime periodike dhe përgatit raporte për eporin. Gjithashtu, siguron që të gjitha ndërhyrjet të jenë në përputhje me legjislacionin dhe standardet teknike në fuqi, si dhe zbaton detyra të tjera në funksion të objektivave të sektorit.

Kandidatët duhet të plotësojnë:

Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës si vijon:

- a. Të jenë shtetas shqiptar;
- b. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të përmbushin kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojnë aftësitë e nevojshme dhe profesionale për vendin e punës;
- e. Të jenë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
- f. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen një kundërvajtjeje penale me dashje;
- g. Të mos jenë marrë ndaj tyre masa disiplinore, që nuk është shuar sipas ligjit;

Kërkesat e veçanta të pozicionit të punës si vijon:

- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit Master profesional/ Master Shkencor apo Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në fushat e Inxhinierisë, e preferueshme; Inxhinieri Ndërtimi, Mekanike, Hidroteknike etj., ose në fusha të ngjashme. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- b. Të kenë jo më pak se 1 vit përvojë pune.
- c. Të kenë aftësi të mira komunikuese, menaxhimi dhe të punës në grup.
- d. Të zotërojnë gjuhën të huaj. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- e. Kualifikime: përbëjnë avantazh;

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin, si më poshtë:

1. Kërkesë për punësim.
2. Jetëshkrim (CV)
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit)
4. Fotokopje të librezës së punës (*të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë*);
5. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
6. Certifikatë familjare
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore,
8. Vërtetim të gjendjes gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) ose Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Mosdorëzimi i dokumenteve të mësipërme dhe mosplotësimi i kritereve, e s'kualifikojnë automatikisht aplikantin.

- Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, paraqiten pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati i III-të, Tiranë, ose në adresën elektronike burimet.njerezore@dshq.gov.al
- Afati përfundimtar për dorëzimin e aplikimit dhe dokumentacionit të sipërcituar është brenda datës: **12.05.2026** (afati i fundit i aplikimit).
- Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të aplikimeve dhe vlerësimit të dokumentacionit, Njësia e Burimeve Njerëzore do të njoftojë individualisht, nëpërmjet e-mail-it zyrtar, kandidatët e kualifikuar për vijimin e fazave të mëtejshme të konkurrimit.